



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 74/2021 (JR)

Tiranë, më 12.12.2024

Nr. 74/19 regj.

SHPALLJE  
E

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se më datë 12.12.2024, në orën 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri 74/2021 (JR), datë 26.11.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Ken Dhima kundër vendimit nr. 428, datë 29.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit Ken Dhima, për t’i dhënë mundësinë e ushtrimit të së drejtës për t’u dëgjuar.

Ftohet subjekti i rivlerësimit të sigurojë prezencën e tij, ose përfaqësimin nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor në seancën gjyqësore publike vijuese që do të zhvillohet në datën **16.01.2025, ora 10:00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese  
Relatore  
Anëtare  
Anëtare  
Anëtare

Ina Rama  
Albana Shtylla  
Natasha Mulaj  
Rezarta Schuetz  
Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES  
GJYQTARE**

  
**INA RAMA**

